




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË KOSOVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës (GJKK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të GJKK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i GJKK-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e shpenzimeve dhe pasurisë.

Ky raport ka rezultuar me dy (2) rekomandime të reja. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 120,000€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 87,181€, apo 73%. Ato kanë të bëjnë me blerjen e veturave zyrtare, renovimeve të objektit dhe blerje të pajisjeve të teknologjisë së informacionit. Blerja e pajisjeve që nuk janë kapitale është identifikuar si mangësi në shpenzimin e këtyre fondeve, që është prezantuar më poshtë.

Çështja A1 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja	<p>Sipas udhëzuesit të planit kontabël, pika 1.221, në kodin 31610 regjistrohen pagesat për blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative dhe të komunikimit, të cilat evidentohen në regjistrin e SIMFK. Po ashtu pika 1.59, në kodin 13504 regjistrohen blerjet për pajisjet në shumën nën 1,000€ për njësi, të cilat evidentohen në e-pasuri.</p> <p>Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka shpenzuar nga investimet kapitale 10,813€, për blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative nën 1,000€, që për nga natyra i përkasin mallrave dhe shërbimeve. Kjo ka rezultuar me keq klasifikim të shpenzimeve në PFV, duke mbivlerësuar investimet kapitale dhe nënvlerësuar mallrat dhe shërbimet.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se planifikimi i buxhetit për blerjen e pajisjeve është bërë nga investimet kapitale, ndërsa pajisjet janë nën 1,000€ dhe i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.</p>
Ndikimi	Keq klasifikimi ndikon në prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve dhe ofron informata të pasakta për lexuesin dhe vendimmarrësit.
Rekomandimi A1	Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që planifikimet për pajisje të teknologjisë informative të bëhen sipas natyrës së tyre duke bërë ndarje të pasurisë kapitale dhe jo kapitale, me qëllim që shpenzimet të jenë të prezantuar drejtë në PFV dhe në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.1.2 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 556,126€, pasurive jokatitale është 48,021, si dhe e stoqeve 2,356€. Regjistrimet gabuara dhe mos regjistrimet e pasurisë, mbetet sfida për GjKK-në, si rrjedhojë janë identifikuar mangësitë e mëposhtme.

Çështja A2 - Regjistra jo të saktë të pasurive

Gjetja Sipas rregullores MF 02/2013, neni 6,3, përcakton së pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin “e-pasuria”.

GjKK nuk kishte prezantuar vlerën e saktë të pasurisë në PFV, (në nenin 19):

- Vlera 1,950€ për renovimin e hapësirave të brendshme të objektit (dera e hyrjes), nuk është evidentuar në regjistrin e SIMFK-së.
- Vlera 1,430€ për renovimin e hapësirave të brendshme të objektit (kuzhina), dhe vlera 995€ për blerjen e laurës së parkingut, nuk janë evidentuar në regjistrin e-pasuria; dhe
- Vlera 1,795€ për trajnimin e stafit është regjistruar gabimisht si pasuri në regjistrin e-pasuria.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarëve përgjegjës dhe mungesës së mbikëqyrjes nga kontrollet në nivel të përgjithshëm të organizatës.

Ndikimi Mangësitë në evidentimin e pasurive kanë shkaktuar regjistra të pa saktë të pasurive si dhe prezantim jo të drejtë dhe të vërtetë të informatave në PFV.

Rekomandimi A2 Sekretari i Përgjithshëm duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive dhe të siguroj që pasuritë evidentohen në regjistra përkatës sipas rregullave në fuqi, në mënyrë që të mundësohet regjistër i plotë i pasurisë dhe raportim i drejtë në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe shpenzimin kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	1,992,123	2,103,441	2,066,104	2,028,918	1,825,629
Grante Qeveritare - Buxheti	1,992,123	2,103,441	2,066,104	1,959,117	1,825,629
Donacionet e jashtme	0	0	0	69,802	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 111,318€, si rezultat i rritjes së grandit qeveritar për paga dhe mëditje.

Në vitin 2024, GJKK ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar ose 2,066,103€, me një ulje prej 1% në krahasim me vitin 2023.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	1,992,123	2,103,441	2,066,104	2,028,918	1,825,629
Pagat dhe mëditjet	1,172,246	1,283,564	1,283,564	1,223,457	1,209,699
Mallrat dhe shërbimet	615,797	608,397	604,956	595,606	541,634
Komunalitë	4,000	8,600	7,576	3,977	2,750
Subvencionet dhe transferet	80,080	82,880	82,826	79,532	71,546
Investimet Kapitale	120,000	120,000	87,181	126,346	0

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

Tek pagat dhe mëditjet, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është rritur për 111,318€, pasi që ndarja fillestare nuk ishte e mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të pagave për 12 muaj. Po ashtu, nga muaji gusht është zbatuar aktgjykimi i GjKK-së për përvojën e punës, duke llogaritur vlerën 0,5% për çdo vit (në vend të 0,25%) për të punësuarit e rinjë, që ka reflektuar si shtesë tranzitore. Realizimi i shpenzimeve për këtë kategori ishte 100%.


Tek mallrat dhe shërbimet, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është ulur për 2,800€, pas kërkesave të GjKK-së për transferin e mjeteve në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, ndërsa realizimi i buxhetit ishte 99%.

Tek komunalitë, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është rritur për 4,600€. Ky ndryshim ishte rezultat i rialokimit të mjeteve nga kategoria Mallra dhe Shërbime me kërkesë të institucionit, pasi që shpenzimet për ngrohje janë bartur nga MPBAP tek GjKK në fund të vitit 2023, pas aprovimit të buxhetit për 2024. Realizimi i buxheti ishte 88%.

Tek subvencionet dhe transferet, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është rritur për 2,800€, si rezultat i transferit të mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime me kërkesë të institucionit. Kjo për shkak të rritjes së shpenzimeve të pagave për stafin mbështetës të ish Kryetarëve. Realizimi i buxhetit për këtë kategori është 100%.

Tek investimet kapitale, buxheti përfundimtar në raport me buxhetin fillestar është i njëjtë dhe realizimi i buxheti është 73%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



GjKK nuk arkëton të hyra të rregullta. Të hyrat e pranura gjatë vitit 2023 kanë të bëjnë me kthimin e mjeteve si rezultat i përfitimit të zbritjes nga një konferencë jashtë vendit.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	0	0		904	
Të hyrat tjera	0	0		904	

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka rezultuar me një rekomandim. GJKK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohet rekomandimi dhe dhënë.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, rekomandimi është zbatuar, dhe përshkrim më i plotë i rekomandimit dhe mënyrën se si është trajtuar, shihni në Tabelën 4.


Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Pasuritë	Sekretari i Përgjithshëm duhet ti forcoj kontrollet e brendshme në fushën e pasurisë, duke siguruar se regjistri i pasurisë përfshinë të gjithë pasuritë e institucionit. Po ashtu, duhet të sigurohet se aplikohet zhvlerësimi i saktë i pasurive, në mënyrë që regjistri i pasurisë për vitin 2024 të paraqet gjendjen e plotë dhe të drejtë të tyre.	GJKK ka ndërmarr masa që pasurisë së regjistruar ti aplikohet zhvlerësimi sipas rregullorës.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Jusuf Kryeziu, Drejtor i Auditimit



Qëndresa Isufi, Udhëheqëse e ekipit



Luljeta Morina, Anëtare e ekipit



Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATË PRANIMIT / RECEIVED: DATË PUBLIKIMIT / PUBLISHED: DATË SHËRBYIMIT / SUBMITTED:			
Niveli Org. Org. Unit	Shifër Klasifikimi Class. Code	Nr. Prot. Prot. No.	Nr. Faqeve No. Pages
05	47	398	1

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
 GJYKATA KUSHTETUESE
 USTAVNI SUD
 CONSTITUTIONAL COURT
 KABINETI I KRYETARIT / URED PREDSEDNIKA / CABINET OF THE PRESIDENT

Prishtinë, më 2 prill 2025
 Nr. Ref.: KK 152/25

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kemi pranuar draft-Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2024.
- **Pajtohem** me gjetjet dhe rekomandimet e dhëna.
- Brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzojmë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Nexhmi Rexhepi
 Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

2 prill 2025, Prishtinë



Perandori Justinian 44, 10000 Prishtinë/a, Kosovë/o
 Tel: +381 (0)38 606 162; Fax: +381 (0)38 606 170; www.gjk-ks.org

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.